



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.1561/5 prot.

Datë 08.06.2026

V E N D I M

Nr. 760/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 08.06.2026 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Modifikimi i dokumenteve të tenderit, për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar” me Nr. REF-85309-05-12-2026, me objekt “Blerje materiale xheniere, elementë ura Bailey.” me fond limit 62,029,048.40 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 12.06.2026, nga autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve te Perqendruara

Ankimues: Operatori ekonomik “Eidon-Grup” SHPK me NIPT L91323019S dhe adresë: Rruga Kodra e Diellit, Ndertesa Nr.2, Hyrja 15, Ap.11, 1044 , Selite, Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Operatori i Blerjeve te Perqendruara me adresë: Rruga “Reshit Çollaku”, godina nr.6/337, Tiranë (në krah të Gjykatës së Lartë)

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për

organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”

Komisioni i Prokurimit Publik pasi shqyrtoi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 13.05.2026, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar” me Nr. REF-85309-05-12-2026, me objekt “Blerje materiale xheniere, elementë ura Bailey.” me fond limit 62,029,048.40 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 12.06.2026, nga autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve te Përqendruara.

II.2. Në datën 19.05.2026, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2026/6681 dhe me nr. 1561/2026 prot., datë 20.05.2026, e operatorit

ekonomik “Eidon-Grup” SHPK, duke kërkuar modifikimin e dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt - ankimi. Dhe konkretisht duke pretenduar:

3. Rrethanat dhe faktet □

Përshkruani rrethanat e faktit. □

Pasi jemi njohur me Dokumentat Standarte të Tenderit me procedurë të hapur (mallra) me objekt: “Blerje materiale xheniere , element ura Bailey” për Ministrinë e Mbrojtjes, Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, Komanda Mbështetëse” me vlerë fillestare 62,029,048.40 (gjashtëdhjetë e dy milion e njëzet e nëntë mijë e dyzet e tetë pikë dyzet) lekë PA TVSH Ose 649 791 (gjashtëqind e dyzet e nëntë mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e një) euro pa tvsh

Zhvilluar nga autoriteti kontraktor: Operatori i Blerjeve të Perqendruara, i cili është parashikuar të zhvillohet me datën 12.06.2026 kemi disa kundërshtime përsa i përket kushteve/kritereve të veçanta për pjesëmarrje dhe kualifikim, konkretisht si me poshte:

1. Shtojca Nr.6 - Formulari i specifikimeve teknike, Pika 2 Garancia e produkteve (Subjekti duhet të japë garanci ligjore për sigurinë dhe qëndrueshmërinë e elementeve pas montimit të tyre në objekte)

Përsa i përket garancisë së produkteve, nëse si operator ekonomik e konsiderojmë si kërkesë jo të pershtatshme pasi lloji i procedurës është Kontratë Publike për furnizim (blerje) dhe subjekti vepron në cilësinë e furnizuesit dhe jo të montuesit, ndaj përgjegjësia kufizohet vetëm në cilësinë, konformitetin dhe përputhshmërinë e materialeve të dorëzuara sipas specifikimeve teknike dhe ofron garanci vetëm për materialet e dorëzuara. Subjekti ofron garanci për defektet e mundshme në prodhim dhe deri në momentin e dorëzimit të mallrave, por nuk është përgjegjës për demtimet apo problematikat që mund të vijnë pas montimit të tyre në objekte.

Në praktikën kontraktore dhe teknike garancia për produktin dhe garancia për montimin trajtohen si dy përgjegjësi të ndara: furnizuesi garanton cilësinë dhe konformitetin e produktit ndërsa montuesi garanton instalimin korrekt dhe funksionalitetin pas vendosjes në objekt. Vendosja e një detyrimi të tillë ndaj furnizuesit cenon parimin e proporcionalitetit në procedurat e prokurimit publik, pasi kërkon marrjen për sipër të përgjegjësisë për procese dhe veprime që nuk administrohen prej tij.

2. Shtojca Nr.8-Formulari i kritereve të përzgjedhjes/kualifikimit, Pika 2.3.5 Operatori ekonomik, në datën dhe orën e zhvillimit të procedurës së prokurimit duhet të paraqesë nga një mostër për çdo artikull, në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara. Mostrat do të dorëzohen në depot e Repartit Ushtarak nr. 4040, batalioni i Xhenios, Rruga “Faik Kulla”, Babrru, Tiranë, jo më vonë se data 12.06.2026 ora 11.00, (*Data e hapjes/dorëzimit të Ofertave). Në bashkë me mostrat ofertuesi duhet të dorëzojë edhe një shkresë të vulosur dhe firmosur ku të listohen mostrat që janë dorëzuar. Mbi çdo mostër të dorëzuar, ofertuesi duhet të shënojë Nr. Rëndor të Artikullit që përfaqëson sipas formularit të çmimit.

Duhet theksuar se kërkesa për paraqitjen e mostrave për çdo artikull në datën e zhvillimit të

procedures permban nje kosto shume e larte per operatorin ekonomik, pasi numri i artikujve eshte i konsiderueshem dhe nuk jane standarte tregu por prodhohen posacerisht per kete objekt dhe sigurohen jashte territorit te Shqiperise. Pergatitje, prodhimi, transporti dhe sjellja e mostrave brenda afateve te procedures kerkon angazhim te konsiderueshem financiar dhe logjistik dhe ekziston rrisht qe mostrat e prodhuara te mbeten te paperdorshme ne rast mosshpallje fitues duke sjell dem ekonomik. Per pasoje nje kerkese e tille eshte diskriminuese dhe perjashtuese duke kufizuar pjesemarrje duke cenon parimin e konkuresces se lire pasi favorizon vetem operatoret qe disponojne paraprakisht produkte te gatshme ose kapacitete te menjehershme furnizimi.

Plotesimi i deklarates se permbushjes se kushteve se mallrat e furnizuara jane sipas specifikimeve dhe standarteve te kerkuara eshte kusht i mjaftueshem per kualifikim. Gjithashtu duhet te theksohet se specifikimet teknike dhe vizatimet e percaktuara nga ana juaj paraqesin modele unike, te cilat ne pjesen me te madhe i perkasin prodhimeve stok te periudhes para viteve 1990 dhe ne asnje nga dokumentet e tenderit nuk eshte bere unifikimi sipas standarteve te sotme per keto elemnte, pra eshte eliminuar dhe perjashtuar konkurenca pasi jane vetem nje prodhim i para viteve 1990.

4. Argumentime mbi shkeljet e pretenduara

Pershkruani ne menyre koncize shkeljet e pretenduara, duke argumentuar qarte dhe sakte se perse pretendoni per paligjshmeri ne veprimet e autoritetit/entit kontraktor.

Si perfundim, kerkojme nga ana e Autoritetit Kontraktor OBP qe te rishikohen dhe te behet ndryshim ne kushtet/kriteret e vecanta per pjesemarrje ne dokumentat standarde te tenderit, konkretisht tek Shtojca Nr.6 - Formulari i specifikimeve teknike, Pika 2 Garancia e produkteve dhe Shtojca Nr.8-Formulari i kriterave te perzgjedhjes/kualifikimit, Pika 2.3.5 Operatori ekonomik, ne daten dhe oren e zhvillimit te procedures se prokurimit duhet te paraqese nga nje moster per cdo artikull, ne perputhje me specifikimet teknike te percaktuara, pasi ne i konsiderojme si kerkese te panevojshme

Duke shpresuar ne mirekuptimin tuaj, mbetemi ne pritje te nje vendimi pozitiv.

II.3. Bazuar ne nenin 112, pika 3 te ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar ne bazen e te dheneve te tij, te dhena per: a) ankimuesin, adresen dhe NUIS-in; b) te dhena te plota per proceduren e prokurimit (objekt, numer reference, fond limit, daten e zhvillimit te procedures), si dhe ankesen e plotë te ankimuesit.

II.4. Te njehiten ankesë per modifikimin e dokumentave te tenderit operatori ekonomik ankimues e dergoi ne KPP edhe permes sherbimit postar e cila u protokollua me tonen me nr. 1561/1 prot., date 21.05.2026.

II.5. Permes shkreses me n. 2142/7 prot., date 25.05.2026 me lendë “Mbi shqyrtimin e e ankeses se paraqitur nga operatori ekonomik “Eidon-Grup” SHPK, lidhur me dokumentet e tenderit, ne proceduren e prokurimit me nr. REF-85309-05-12-2026, me objekt: “Blerje material xheniere, elemente ura Bailey” autoriteti kontraktor ka derguar ne KPP vendimin e KSHA me nr. 84/2026 date 22.05.2026 ku rezulton se ka vendosur refuzimin e ankeses duke argumentuar:

mostër për çdo artikull, në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara, pasi në i konsiderojmë si kërkesa të panevojshme

Duke shprehur në mirëkuptimin tuaj, mbetemi në pritje të një vendimi pozitiv.

II.

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave

Pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit të paraqitur në SPE si dhe informacionit të vendosur në dispozicion nga Njësia e Prokurimit:

ARSYETON:

Në datën 20.05.2026, Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike të Komisionit të Prokurimit Publik nëpërmjet portalit e-Albania, pranë Komisionit të Prokurimit Publik me numër protokollit 1561/2026, datë 20.05.2026 dhe Nr. aplikimi të ankesës online: A/2026/6682, nga ku rezulton se nuk është paraqitur mandatpagesa që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën e paraqitur (Statusi i mandat pagesës: Pa paraqitur).

Në Nenin 111 "Paraqitja e ankesës" të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", (i ndryshuar), parashikohet shprehimisht se:

"1. Operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik në Sistemin e Ankesave Elektronike.

Rregulla të posaçme për mënyrën e paraqitjes së ankesës përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.

2. Ankesa bëhet sipas formularit përkatës, ku shënohen emri dhe adresa e ankuesit, referimi për procedurën konkrete dhe bazën ligjore, ku ankuesi pretendon për shkeljet, pagesa e tarifës së ankesës, duke e shoqëruar atë me dokumentacionin dhe provat përkatëse, për të cilat mendon se mbështesin ankimin e tij. Elementet e sipërpërmendura janë të domosdoshme për shqyrtimin e ankesës. Ankimuesi është i detyruar t'i bashkëlidhë ankimit dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën.

3. Nëse mungon ndonjë nga elementet e sipërpërmendura ose formulari nuk është plotësuar në mënyrën e duhur, atëherë autoriteti ose enti kontraktor duhet të vërë në dijeni ankimuesin për të plotësuar formularin. Njoftimi mund të bëhet me çdo mjet të mundshëm, përfshirë edhe postën elektronike, dhe në çdo rast dokumentohet. Nëse ankesa nuk korrigjohet brenda 2 ditëve nga njoftimi, ajo vlerësohet si e paparaqitur.

4. Në çdo rast, paraqitja e ankesës shoqërohet me mandatpagesën e bërë pranë Komisionit të Prokurimit Publik."

Gjithashtu në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" (i ndryshuar), Kreu XII, Neni 94, përcaktohet se:

"1. Çdo operator ekonomik, i cili ka ose ka pasur interes të ligjshëm 84 në një procedurë prokurimi sipas LPP, dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga veprimet ose mosveprimet e autoritetit/entit kontraktor, për të cilat pretendon se janë në kundërshtim me ligjin, ka të drejtë të ankohet pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

2. Operatori ekonomik ankimes dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik në Sistemin e Ankesave Elektronike.

3. Ankimesi përdor formularin standard të ankesës, që përmban të paktën: emrin, adresën, adresën elektronike të ankimesit, referencën e procedurës konkrete, bazën ligjore, si dhe një përshkrim të shkëlqes së pretenduar.

Ankimesi është i detyruar të bëjë pagesën e tarifës për llogari buxhetit të shtetit. Dokumenti bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën duhet t'i bashkëlidhet ankimit, që ankimesi do të paraqesë në autoritetin/entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike. Kur është e mundur, ankimit i bashkëlidhet një kopje e aktit, që kundërshtohet.

4. Në rast se autoriteti/enti kontraktor konstaton se ankesa nuk është bërë sipas formularit standard ose i mungon ndonjë prej elementeve të sipërpërmendura ose nuk është shoqëruar me mandat pagesën, duhet të vërë në dijeni ankimesin për të plotësuar formularin.

Njoftimi bëhet në Sistemin e Ankesave Elektronike.

Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të njoftojë Komisionin e Prokurimit Publik lidhur me veprimet e mësipërme, për korrigjimin e të metave të ankesës.

5. Ankesa duhet të korigjohet dhe paraqitet në autoritetin/entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik brenda 2 (dy) ditëve nga njoftimi.

Nëse ankesa nuk korigjohet/plotësohet brenda këtij afati, ajo vlerësohet si e paparaqitur.

Nëse afati i fundit bie gjatë ditëve të pushimit zyrtar, atëherë afati i fundit për plotësimin e ankesës do të jetë ditën pasardhëse të punës.

6. Formulari standard i ankesës hartohet nga APP-ja, në bashkëpunim me Komisionin e Prokurimit Publik, dhe është pjesë e dokumenteve standarde të tenderit."

Referuar bazës ligjore të sipërcituar, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, me anë të rubrikës "Kërkesë për informacion OE" nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, në datë 20.05.2026 dërgoi kërkesën për plotësimin e mangësive të konstatuara lidhur me mosparaqitjen e dokumentit bankar, i cili vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën e paraqitur.

Pas përfundimit të afatit kohor të përcaktuar në pikën 3 të Nenit 111 të LPP, u konstatua se plotësimi i kësaj mangësie nuk u korrigjua nga ana e Operatorit ekonomik ankimes.

Duke mbajtur në konsideratë faktin që, sipas LPP dhe Rregullave të Prokurimit Publik, shqyrtimi administrativ i nënshtrohet dy fazave: asaj të shqyrtimit paraprak (në të cilin vlerësohen forma e ankimit, legjitimitimi, juridiksioni, kompetenca dhe nuk i jepet zgjidhje në thelb ankimit) dhe asaj të shqyrtimit në thellim të ankimit, në rastin konkret, ankimi administrativ i paraqitur nga OE ankimes nuk mund të konsiderohet si ezaurim i formës së ankimit, pasi mungojnë elementët e domosdoshëm ligjore që duhet të përmbajë një ankim administrativ, në kontekstin e prokurimit publik.

KSHA pas verifikimeve konstaton se Operatori ekonomik ankimes edhe pse i është vënë në dispozicion i gjithë informacioni i nevojshëm ligjor në lidhje me mënyrën dhe formën paraqitjes

së ankesës, ai sërish nuk ka mundur që të korrigjojë mangësitë e identifikuara në lidhje me pagesën e tarifës financiare brenda 2 ditëve nga njoftimi.

Sa më sipër argumentuar, KSHA gjykon se për sa kohë, ankesa e paraqitur nga Operatori ekonomik ankimues “Eidon-Grup” shpk nuk plotëson kushtet formale, siç është dhe pagesa e tarifës, rrjedhimisht kjo ankesë duhet refuzuar.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në Nenin 114 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, (i ndryshuar), dhe Nenit 102 të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, (i ndryshuar), Komisioni i ngarkuar për Shqyrtimin e Ankesave,

VENDOSI

1. Refuzimin e ankesës së paraqitur nga Operatori ekonomik “Eidon-Grup” shpk.
2. Personi përgjegjës për prokurimin të njoftojë për vendimin e marrë ankimuesin, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi.
3. Personi përgjegjës për prokurimin të njoftojë për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës.
4. Ky vendim i njoftohet menjëherë Titullarit të Organit Qëndror Blerës.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues, informacionit dhe dokumentacionit të paraqitur nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Para shqyrtimit në themel të ankesës së operatorit ekonomik ankimues, KPP gjykon të ndalet fillimisht në plotësimin e kushteve formale nga ana e tij lidhur me tarifën e pagesës financiare. Nisur nga informacioni i autoritetit kontraktor dhe nga verifikimet në sistemin e

ankesave elektronike rezulton e provuar se autoriteti kontraktor me datë 20.05.2026 i ka kërkuar operatorit ekonomik plotësimin e të metave të ankesës në kuptim të nenit 111 pika 3 të *lex specialis*. Sipas informacionit të autoritetit kontraktor operatori ekonomik nuk është përgjigjur brenda 2 ditësh për rregullimin e të metave të ankesës lidhur me pagesën e tarifës financiare ndaj e ka refuzuar atë pa e shqyrtuar në themel. Nga ana tjetër KPP vëren se ankimuesi ka ngarkuar në sistemin e ankesave elektronike mandat pagesën e kryer pranë një banke të nivelit të dytë me datë 19.05.2026, ku vlera dhe përshkrimi lidhen me procedurën e prokurimit objekt ankimi. Në këtë kuadër KPP ka ndryshuar statusin e pagesës së tarifës financiare nga “pa paraqitur mandat pagesë” në “Paguat mandat pagesë” dhe ky përbën fakt të mjaftueshëm për shqyrtimin në themel të ankesës me numër ankimi elektronik A/2026/6681 dhe me nr. 1561/2026 prot., datë 20.05.2026. nga KPP. Ndërsa ankesa me nr. 1561/1 prot., datë 21.05.2026 nuk do të merret në shqyrtim pasi përveçse ka të njëjtin mandat pagesë me ankesën e paraqitur në sistem, gjithashtu nuk është ndjekur rruga e duhur ligjore për paraqitjen e saj sepse në kuptim të nenit 110 pika 8 të *lex specialis* parashikohet se: “[...]Ankesa quhet e pranuar në ditën e depozitimit të saj pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në Sistemin Elektronik të Ankesave.”

III.2. Lidhur me pretendimet e ankimuesit për modifikimin e dokumenteve të tenderit për procedurën e prokurimit objekt - ankimi, duke kërkuar heqjen e mostrave të kërkuara nga autoriteti kontraktor, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.2.1. Në shtojcën nr. 7 të dokumenteve të tenderit “Formulari i sasisë dhe grafikut të lëvrimit” autoriteti kontraktor ka parashikuar:

Shtojca 7.

FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet:

Nr.	Emërtimi I artikullit	Nj/matëse	Sasia
1	Lungerina e rrafshtë	copë	400
2	Tirantë diagonale	copë	130
3	Morseta	copë	520
4	Kunje paneli (Spinot)	copë	700
5	Mbështetëse cilindrike (kuzhineta)	copë	72

6	Korniza lidhëse	copë	50
7	Panele	copë	280
8	Trarë MIA	copë	128
9	Pajanta	copë	120
10	Bllok lidhës	copë	16
11	Pllaka bazë	copë	24
12	Kapele e këmbës së urës	copë	12
13	Mbështetëse e këmbës së urës	copë	12
14	Bulona me veshë	copë	1,200

Mbyllet me nr. 14 (katërmbëdhjetë)

Afati i lëvrim: Lëvrimi i materialeve të bëhet brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga data e lidhjes së kontratës.

Materialet do të dorëzohen në depot e Repartit Ushtarak nr. 4040, batalioni i Xhenios, Rruga “Faik Kulla”, Babrru, Tiranë, të cilat do të përcaktohen në kontratë.

III.2.2. Në shtojcën 8 të dokumenteve të tenderit “Kapaciteti teknik” pika 2.3.5, autoriteti kontraktor ka parashikuar:

2.3.5 Operatori ekonomik, në datën dhe orën e zhvillimit të procedurës së prokurimit duhet të paraqesë nga një mostër për cdo artikull, në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara.

a) Mostrat do të dorëzohen në depot e Repartit Ushtarak nr. 4040, batalioni i Xhenios, Rruga “Faik Kulla”, Babrru, Tiranë, jo më vonë se data 12.06.2026 ora 11.00, (*Data e hapjes/dorëzimit të Ofertave).

– Se bashku me mostrat ofertuesi duhet të dorëzojë edhe një shkresë të vulosur dhe firmosur ku të listohen mostrat që janë dorëzuar.

– Mbi çdo mostër të dorëzuar, ofertuesi duhet të shënojë Nr. Rëndor të Artikullit që përfaqëson sipas formularit të çmimit.

III.2.3. Në nenin 77 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiron vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

III.2.4. Neni 40, pika 3, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”* i ndryshuar, parashikon shprehimisht se :

“Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

III.2.5. Në nenin 40 pika 6 germa a) të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”* i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial 38 tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit;

III.2.6. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se në përcaktimin apo vendosjen e kriterëve specifike, që në thelb konsiderohen si kriterë fituese, për shkak të rëndësisë që kanë, ligjvënësi i ka parashikuar kufizime autoriteteve kontraktore brenda diskrecionit që ka në përzgjedhjen e tyre. Në këtë mënyrë, dispozitat e sipërpërmendura, urdhërojnë, se përcaktimi i këtyre kriterëve duhet të jetë: (i) në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës (ii) Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt-prokurimi. Autoriteti kontraktues është në të drejtën e tij për të përcaktuar kriteret për kualifikim, mjafton që ato të mos jenë diskriminuese e përjashtuese.

III.2.7. Referuar pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues të paraqitura në ankesë Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se është me vend të ndalet në faktin nëse kërkesa për paraqitjen e mostrave për secilin prej artikujve të kërkuar nga autoriteti kontraktor është në proporcion me objektin e kontratës që do të prokurohet në zbatim të nenit 77 pika 1 të LPP-së. Në rastin konkret KPP konstaton, se synimi bazë i autoritetit kontraktor është vërtetimi se subjektet ofertuese zotërojnë kapacitetet e nevojshme për realizimin e kontratës. KPP konstaton, se për përmbushjen e këtij synimi, autoriteti kontraktor ka parashikuar në dokumentet e procedurës së prokurimit jo vetëm kritere kualifikimi të cilat lidhen me vërtetimin e kapacitetit teknik, por edhe kritere të tjera kualifikimi të cilat lidhen me vërtetimin e plotësimit të specifikimeve teknike të produktit me anë të dorëzimit të mostrave, por KPP gjykon, se kërkesa e mësipërme e autoritetit kontraktor mbi dorëzimin e mostrave për artikujt e përcaktuar nga autoriteti kontraktor, nuk është një kërkesë në përputhje me objektin e prokurimit, si dhe me volumin dhe përmasat e kontratës dhe shkon përtej asaj se çfarë është e nevojshme për realizimin e synimit. Mostra në vetvete ka qëllim verifikimin e përputhshmërisë së specifikimeve teknike të artikujve me specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor, qëllim i cili përmbushet nga operatorët ekonomikë me paraqitjen e skedës teknike, katalogëve ose prospekteve të cilët autoriteti kontraktor në mënyrë alternative i ka kërkuar si kusht për kualifikim në pikën 2.3.3 të kriterëve të veçanta të kualifikimit. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson, se verifikimi i përputhshmërisë së specifikimeve teknike të autoritetit kontraktor me specifikimet teknike të artikujve, sigurohet nga operatorët ekonomikë që shfaqin interes për të marrë pjesë në procedurën e prokurimit edhe përmes paraqitjes së katalogëve/prospekteve/skedës teknike të prodhuesit siç është përcaktuar në dokumentet e tenderit. Në këtë kuadër KPP gjykon se kërkesa e autoritetit kontraktor e përcaktuar në pikën 2.3.5 të kriterëve të veçanta të kualifikimit, lidhur me paraqitjen e mostrave për artikujt objekt prokurimi, është një kërkesë e ekzagjeruar dhe në kundërshtim me qëllimin e *lex specialis* si dhe rregullat e prokurimit publik, të cilat kanë si synim nxitjen e konkurrencës dhe sigurimin e një trajtimi të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomik pjesëmarrës në procedurat e prokurimit, prandaj autoriteti kontraktor duhet të marrë masa për heqjen e këtij kriteri për kualifikim nga dokumentet e tenderit të procedurës së prokurimit objekt - ankimi.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik për pikën 2 “Garancia e produkteve” të specifikimeve teknike konkretisht për: *“Subjekti duhet të japë garanci ligjore për sigurinë dhe qëndrueshmërinë e elementëve pas montimit të tyre në objekte.”* KPP vëren se,

III.2.1. Në shtojcën nr. 6 të dokumenteve të tenderit “Formulari i specifikimeve teknike” ndër të tjera autoriteti kontraktor ka parashikuar:

2. Garancia e produkteve

- Subjekti duhet të japë garanci ligjore për sigurinë dhe qëndrueshmërinë e elementëve pas montimit të tyre në objekte.
- Të bëjë ndërrimin e tyre nëse shfaqen defekte apo probleme gjatë montimit të elementëve apo në punë e urës.

Specifikimet teknike të vendosura nga ana e AK, shprehin tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe në përputhje të plotë me funksionet e kërkuara

III.2.2. Në nenin 36 të ligjit nr. 162/2020 ‘Për prokurimin Publik’ i ndryshuar përcaktohet se:

“1. Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet.

Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj.

Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale.

Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik. 3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:

a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;

b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;

c) kërkesave në terma funksionalë sipas shkronjës “a”, referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës “b” të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;

ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi

ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “b” të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshtatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente.

6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “a” të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.”

III.2.3. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, është e nevojshme të ndalet në një interpretim të zgjeruar të dispozitës së lex specialis, mbi mënyrën e hartimit të specifikimeve teknike. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, autoritetet kontraktorë në hartimin e specifikimeve teknike, krahas përshkrimit të saktë të nevojave të këtij të fundit, duhet të kenë në vëmendje faktin se, hartimi i specifikimeve teknike duhet bërë në një mënyrë gjithëpërfshirëse duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve, duke përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë karakteristikat e mallrave/shërbimeve/punëve dhe në përputhshmëri me objektin e kontratës.

Për këtë qëllim ligjvënësi ka parashikuar, se këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore, nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj.

Ligjvënësi ka parashikuar qartësisht në nenin 36 pika 2 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik. Në respekt të parimit të mësipërm, specifikimet teknike, në asnjë rast nuk duhet të diskriminojnë/përjashtojnë nga konkurrimi operatorët ekonomikë ofertues dhe/ose prodhuesit. Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktorë duhet të shmangin çdo formë diskriminimi, qoftë ato të dukshme, qoftë ato të fshehta, të cilat kanë të njëjtin efekt.

Në asnjë rast, specifikimet teknike nuk duhet të hartohen në mënyrë që të drejtojnë drejt një produkti/malli/shërbimi, që ofrohen nga një operator i vetëm ekonomik ose nga një prodhues i vetëm. KPP gjykon se, parashikimet e mësipërme duhet të zbatohen në të gjitha procedurat e

prokurimit, me përjashtim të rasteve ku vetë ligji i prokurimit publik, parashikon një përjashtim të tillë.

Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktorë duhet të mbajnë në vëmendje faktin se specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36 të LPP dhe që i vlerëson punët/mallrat/shërbimet si të pranueshme për funksionet e kërkuara. Gjithashtu, duke u ndalur në pikën 3 të nenit 36 të ligjit për prokurimin publik, KPP-ja gjykon se, ligjvënësi ka parashikuar katër metoda kryesore në hartimin e specifikimeve teknike.

Metoda e parë lidhet me kërkesat funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t'u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktorë të japin kontratën. Metoda e dytë mbështet në standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve.

Metoda e tretë përfshin kërkesat në termat funksionale sipas metodës së parë, por referuar specifikimeve teknike të hartuara sipas metodës së dytë, si një mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale, si edhe të të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të nenit 36 të ligjit për prokurimin publik, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj” në hartimin e specifikimeve teknike dhe kjo duhet pasqyruar edhe në dokumentet e tenderit. Nga interpretimi teleologjik (qëllimi i normës juridike), arrijmë në përfundim, se e rëndësishme është që përmes specifikimeve teknike, autoriteti kontraktor të mundësojë një konkurrim të drejtë, të hapur, e gjithëpërfshirës, të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, si edhe të mos drejtohen drejt një produkti të vetëm të ofruar nga një operator i vetëm ose nga një numër i kufizuar operatorësh ekonomikë.

Gjithashtu referuar nenit 42 të Direktivës 24/2014 “Për prokurimin publik” KE, parashikohet se: “Specifikimet teknike siç përcaktohen në pikën 1 të Shtojca VII do të përcaktohet në dokumentet e prokurimit. Specifikimi teknik përcakton karakteristikat, që kërkohen për një punë, shërbim ose furnizim”. Në pikën 1 të Shtojcës VII të Direktivës parashikohet se: "specifikim teknik" nënkupton njërën nga sa vijon: b) në rastin e kontratave të furnizimit publik ose shërbimeve, një specifikim në një dokument që përcakton karakteristikat e kërkuara të një produkti ose një shërbimi, siç janë nivelet e cilësisë, nivelet e performancës mjedisore dhe klimatike, modelimi për të gjithë kërkesat (përfshirë aksesin e personave me aftësi të kufizuara) dhe vlerësimin e konformitetit, performancën, përdorimin e tyre produkti, siguria ose dimensionet, përfshirë kërkesat që lidhen me produktin në lidhje me emrin nën të cilin produkti shitet, terminologji, simbole, metodat e provës dhe provës, paketimin, markimin dhe etiketimin, përdorues-udhëzimet, proceset e prodhimit dhe metodat në çdo fazë të ciklit jetësor të furnizimit ose shërbimit dhe procedurat e vlerësimit të konformitetit.

Në vendimin e GJED Çështja C-368/10 “Komisioni Evropian vs. Mbretëria e Holandës” inter alia dhe mutatis mutandis është arsyetuar se: “Specifikimet teknike të hartuara nga blerësit publik duhet të lejojnë që prokurimet publike të hapen në konkurrencë. Për këtë qëllim, duhet të jetë e mundur të dorëzohen tenderë që pasqyrojnë larminë e zgjidhjeve teknike. Prandaj, duhet të jetë e mundur të hartohen specifikimet teknike për sa i përket performancës funksionale dhe kushteve, dhe kur referimi bëhet në standardin Evropian ose, në mungesë të tij, ndaj standardit kombëtar, ofertuesit bazuar në marrëveshje ekuivalente duhet të merren në konsideratë nga autoritetet kontraktuese.”

III.2.4. KPP-ja gjykon, se vetë ligjvënësi ka parashikuar në nenin 2 germa “dh” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, se qëllimi i ligjit të prokurimit publik, si ligj material i zbatueshëm për shqyrtimin administrativ të ankesave të operatorëve ekonomikë, është ndër të tjera të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik. Ashtu si edhe GJED ka nënvizuar ndër vite, parimi i transparencës dhe i barazisë janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën, por detyra thelbësore e transparencës në një procedurë prokurimi është që të krijohen kushte dhe rregulla të hollësishme për të gjitha palët në proces.

III.2.5. Lidhur me pretendimet e ankimuesit dhe pas verifikimit të përmbajtjes së specifikimeve teknike më sipër objekt ankese, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoritetet kontraktore në hartimin e kriterëve dhe/ose specifikimeve teknike krahas përshkrimit të saktë të nevojave të këtij të fundit, duhet të kenë në vëmendje faktin, se hartimi i tyre duhet bërë në një mënyrë gjithëpërfshirëse, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve, duke përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë karakteristikat e mallrave/shërbimeve/punëve dhe në përputhshmëri me objektin e kontratës. Në asnjë rast kriteret dhe/ose specifikimet teknike nuk duhet të hartohen në mënyrë që të drejtojnë drejt një produkti/malli/shërbimi që ofrohet nga një operator i vetëm ekonomik ose nga një prodhues i vetëm. Duke parë mënyrën e hartimit të këtij specifikimi, pretendimet e ankimuesit si dhe nga analiza e përmbajtjes së dokumenteve të tenderit del e qartë se jemi vetëm para natyrës së kontratës së furnizimit me mallra, jo edhe të vendosjes së tyre. Në këtë kuadër ashtu siç me të drejtë ankimuesi pretendon subjekti vepron në cilësinë e furnizuesit në këtë kontratë, jo edhe të montuesit dhe si rrjedhojë garancia për mallin duhet të ofrohet nga momenti i prodhimit deri në momentin e dorëzimit të tij. Të gjitha proceset e tjera të punës përfshirë edhe montimin nuk e vendosin furnizuesin përballë pozitës detyruese për të garantuar cilësinë e mallit pasi proceset mekanike të punës referuar dokumenteve të tenderit i japin atyre një natyrë jashtë kontraktor për të cilën subjekti nuk ka pse të ofrojë asnjë garanci. KPP thekson faktin që vërtetë hartimi i kriterëve për kualifikim dhe specifikimeve teknike është lënë në diskrecion të autoritetit kontraktor por ky diskrecion nuk është i pa kufizuar pasi hartimi i tyre duhet të jetë gjithnjë në përputhje me ligjin dhe rregullat e prokurimit publik si dhe me legjislacionin sektorial në fuqi si dhe nuk duhet të kufizojnë konkurrencën dhe të orientojnë drejt një prodhuesi të vetëm. Sa më sipër autoriteti kontraktor duhet të marrë masa për heqjen e specifikimit teknik që e lidh garancinë me sigurine dhe qëndrueshmërinë e elementëve pas montimit të tyre në objekte pasi

jemi përballë kontratës së furnizimit dhe përgjegjësia e tij mbi cilësinë kufizohet nga momenti i prodhimit deri në dorëzimin e tyre.

Sa më lart pretendimi i ankimuesit qëndron.

III.3. Ndërsa lidhur me pretendimet e ankimuesit se *“Gjithashtu duhet te theksohet se specifikimet teknike dhe vizatimet e percaktuara nga ana juaj paraqesin modele unike, te cilat ne pjesen me te madhe i perkasin prodhimeve stok te periudhes para viteve 1990 dhe ne asnje nga dokumentet e tenderit nuk eshte bere unifikimi sipas standarteve te sotme per keto elemnte, pra eshte eliminuar dhe perjashtuar konkurenca pasi jane vetem nje prodhim i para viteve 1990.”* KPP vëren se mungon thelb i kërimit dhe KPP nuk vendoset në pozitën e ankimuesit duke hamendësuar mbi objektin e kërimit për sa kohë ligjvënësi ju ka dhënë mundësi subjekteve të cilat pretendojnë se ju cënohen interesat e tyre të ligjshme nga veprimet apo mosveprimet e autoritetit kontrktor, që të investojnë KPP përmes instrumentit të ankimit duke e bërë të qartë dhe të identifikueshëm kërkimin i cili në këtë rast mungon . Sa më lart pretendimi i mësipërm nuk merret në shqyrtim.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 30 dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të pranojë pjesërisht ankesën me numër ankimi elektronik A/2026/6681 dhe me nr. 1561/2026 prot., datë 20.05.2026 të operatorit ekonomik “Eidon-Grup” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar” me Nr. REF-85309-05-12-2026, me objekt “Blerje materiale xheniere, elementë ura Bailey.” me fond limit 62,029,048.40 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 12.06.2026, nga autoriteti kontrktor Operatori i Blerjeve te Perqendruara.
2. Të mos pranojë ankesën me nr. 1561/1 prot., datë 21.05.2026 të operatorit ekonomik “Eidon-Grup” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit, të dërguar në KPP me shërbim postar.
3. Autoriteti kontrktor të kryejë modifikimet e dokumenteve të tenderit sipas konstatimeve të mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik.

4. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi duke dokumentuar veprimet e kryera.
 5. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “Eidon-Grup” SHPK.
 6. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiovent Zguro

